

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe neni 83 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), nenit 80, paragrafi (5) nga Ligji i njëjtë, nenit 51, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe nenit 52, paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), nenit 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), nenit 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026 për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr. 08-66 datë 19.3.2026 për miratim të vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-1174/7 datë 24.3.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 23.3.2026, miratoi:

**VENDIM**  
**për heqjen e lejes për transmetim televiziv të**  
**Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive**  
**TV GURRA ShPKNjP Kërçovë**

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor – 30 ditë nga dita e pranimit të Faturës nr.2026-100-0020 datë 12.1.2026 (ark.nr.05-106/1 datë 12.1.2026).

2. Fatura nr. 6p.2026-100-0020 datë 12.1.2026 (ark.nr.05-106/1 datë 12.1.2026) anulohet dhe subjektit nga pika 1. të këtij Vendimi, i jipet faturë e re, që i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes, dhe pagesa duhet të kryhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së faturës.

3. Vendimi publikohet në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“, në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resor (burim) të kufizuar, në nivel lokal, në zonën e (komunës së Kërçovës, komunës Pllasnicë dhe komunës Makedonski brod), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Në pajtim me nenin 80, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV), për lejen e transmetimit televiziv ose radio transmetuesit, me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajn kompensim vjetor në llogari të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me këtë ligj. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 të LShMAAV).

Në lidhje me kompensimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, Agjencia më 12.1.2026, i dërgoi Faturë me nr.2026-100-0020 datë 12.1.2026 (nr.ark.05-106/1 datë 12.1.2026), sipas së cilës transmetuesi ishte i detyruar të paguante 118.740,00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) denarë për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv, për periudhën nga data 5.1.2026 deri më 4.1.2027. Fatura u dërgua me shkrim me postë rekomanduese me datë 12.1.2026, por nuk u pranua dhe iu kthye Agjencisë me shënimin „nuk është kërkuar“. Me datë 28.1.2026, fatura iu dërgua përsëri transmetuesit, por përsëri nuk u pranua dhe iu kthye Agjencisë me shënimin „nuk është kërkuar“. Duke pasur parasysh se pas dy përpjekjeve të Agjencisë, transmetuesi nuk e pranoi faturën, më 6.2.2026 iu dërgua në formë elektronike në e-mail adresë të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV) dhe në regjistrin e radiodifuzerëve që udhëhiqet nga Agjencia. Deri me datë 7.3.2026, që ishte dhe afati i fundit ligjor për pagesë të kompensimit, ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 118.740,00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) denarë.

Në pajtim me nenin 27, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LshMAAV dhe dispozitat e miratura në bazë të ligjit (neni 29 paragrafi 1 të LShMAAV).

Agjencia, nëpërmjet Sektorit për financa dhe logjistikë, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor të lejes, ku pas mbikëqyrjes së kryer administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr.ark.05-914/1 datë 9.3.2026), është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk ka përmbushur detyrimet ligjor të përcaktuara në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në llogari të Agjencisë.

Në nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 3 të LShMAAV, është përcaktuar se nëse konstaohet mosrespektim, cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore, miratuar në bazë të ligjit, si dhe shkelje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akteve të tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të LShMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë leja dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim, nëse zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes në afatin e parashikuar me ligj.

Procedura për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83, paragrafi (1) të LShMAAV, inicohet nga Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke marrë parasysh gjendjen e përcaktuar faktike, sipas së cilës zotëruesi i lejes, ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, në afatin e përcaktuar me ligj prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin e nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV, përkatësisht zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e parashikuar me ligj, Drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 83, paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të

LShMAAV, dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026 për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 11-të mbajtur më 10.3.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr. ark. 02-916/2 datë 10.3.2026, miratoi Propozimin PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë.

Në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes të ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia dërgoi Njoftim drejtuar transmetuesit në fjalë (PA1 nr.08-66 datë 10.3.2026), ku është sugjeruar se nëse nuk e paguan plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, dhe në pajtim me nenin 85, paragrafi (2) të LShMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Njoftimi me shkrim PA1 nr.08-66 datë 10.3.2026, iu dërguar me postë rekomanduese ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, ndërsa më 11.3.2026 iu dërgua dhe në formë elektronike në e-mail adresë të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e radiodifuzerëve të udhëhequr nga Agjencia.

ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë më 17.3.2026, nga e-mail adresa zyrtare e transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV, drejtua Agjencisë dorëzoi Kërkesë (nr ynë.ark.05-1118/1) për vazhdim të aftit për pagesë të kompensimit të lejes deri më 31.3.2026, në lidhje me të cilën Agjencia e njoftoi se afati për pagesën e kompensimit të lejes është parcaktuar me ligj sipas nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV (30 ditë nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia) dhe nuk mund të vazhdohet, dhe se afati i fundit për të cilin ekziston mundësia për kryerjen e pagesës së kompensimit është 23.3.2026, deri në këtë datë Këshilli i Agjencisë është ligjërisht i detyruar të miratojë vendim sipas procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Prandaj, duke pasur parasysh faktin se zotëruesi i lejes ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë dhe në afatin prej 15 (pasëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përbushur detyrimin e përcaktuar të nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV, Drejtori i Agjencisë dorëzoi Propozim PA1 nr.08-66 datë 19.3.2026, sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe nenit 83, paragrafi (3) të LShMAAV, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, nr.ark.02-1174/7 од 24.3.2026, miratoi Vendim me të cilin i hiqet leja PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023 për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar plotësisht kompensimin e lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar me ligj.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë, derisa zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dërguar në afatin e cekur në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, anulohet dhe i jipet faturë e re që i referohet vetëm periudhës së punës, dhe kjo faturë paguhet në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e dhënies. Përndryshe pagesa e borxhit kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Fatura me nr.2026-100-0020 datë 12.1.2026 (nr.ark.05-106/1 datë 12.1.2026) për kompensim të lejes për transmetim televiziv, anulohet dhe ShTR TV GURRA ShPKNjP Kërçovë, i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes dhe duhet të paguhet jo më vonë se dita e 8 (tetë) nga dita e dhënies së faturës.

Në pajtim me nenin 84 të LShMAAV, Vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi, zotëruesi i lejes ka të drejtë të paraqes padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente. Bazuar në sa më sipër, u miratua Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
mr. Sasho Stefanovski**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për heqjen e lejes, ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi.

Përktheu: Antoneta Shabani